



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

HULUMTIM:

IDENTIFIKIMI I NGARKESËS ME LËNDË, PËRMES ANALIZIMIT TË TË
DHËNAVE MBI GJENDJEN E VEPRAVE PENALE KARAKTERISTIKE
2013-2016 ME QËLLIM TË PLANIFIKIMIT TË VEPRIMEVE PËR
NGRITJEN E EFIKASITETIT NË ZGJIDHJEN E LËNDËVE TË REJA

Mars 2017, Prishtinë

PËRMBAJTJA

Parantezë.....	3
Hyrje.....	4
1 Analiza mbi efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve të pranuar me qëllim të identifikimit të ngarkesës me lëndë.....	5
2 Trendi i pranimet të kallëzimeve penale me persona.....	8
3 Indeksi i ngarkesës me lëndë.....	8
4 Ngarkesa me lëndë në vitin 2016 dhe ngarkesa e pretenduar me lëndë në vitin 2017.....	9
5 Identifikimi i prokurorive dhe llojit të veprave penale që krijojnë ngarkesën me lëndë..	9
6 Planifikimi i zvogëlimit të ngarkesës me lëndë në dinamikën e normës orientuese.....	10
6.1 Prokuroria Themelore në Prishtinë.....	10
6.2 Prokuroria Themelore në Mitrovicë.....	11
7 Identifikimi i veprave penale të cilat duhet të inkorporohen në grupin e trafikimit me qënje njerëzore.....	12
8 Konkluzione	13
9 Rekomandime.....	14
Shtojca.....	18

PARANTEZË

Krijimi dhe funksionalizimi i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional ka qenë një prej kritereve të BE-së ndaj Republikën e Kosovës, në kuadër të proceseve të integrimi Evropiane. Qëllimi parësor i këtij instrumenti ka qenë

Qëllimi i krijimit të Mekanizmit përcjellës Ndërinstitucional ishte konstruktimi i një sistemi përmes të cilit do të mundësohej ecuria e procedurave dhe veprimeve të institucioneve përgjatë fazavës së zbulimit, hetimit, ndjekjes, gjykit dhe ndërkim të kryesve të veprave penale karakteristike.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka realizuar zotimin e marrur në emër të të gjitha Institucioneve të përfshira në Mekanizmin përcjellës, për krijimin e bazës së të dhënave, regjistrimin dhe harmonizimin e të gjitha të dhënave për veprimet procedurale dhe hartimin e raporteve periodike.

Raportet periodike të Mekanizmit përcjellës kanë shpërfaqur disa sfida, ndaj të cilave Këshilli Prokurorial i Kosovës, në kuadër të krijimit të politikave strategjike, ka krijuar instrumente adekuate për zgjidhjen e tyre, siç janë:

- Koordinatori nacional për zbatimin e rregullores për ngritjen e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit;
- Koordinatori nacional për zbatimin e rregullores për ngritjen e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin;
- Hartimin e planit strategjik dhe planit të veprimit 2016-2018 për rritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në zvogëlimin e ngarkesës me lëndë përmes ngritjes së efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të pranuar për veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, duke përfshirë:
 - o Krijimin e Njësitit të posaçëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë për zbatimin e planit strategjik për zvogëlimin e ngarkesës me lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike;
 - o Krijimin e dy mekanizmave mbikëqyrës për zbatimin e planit strategjik dhe planit të veprimit 2016-2018:
 - Komisioni mbikëqyrës për lëndët e korrupsionit, dhe
 - Koordinator kombëtar për mbikëqyrjen e lëndëve të krimeve ekonomike duke përfshirë edhe sekuestrimin e konfiskimin.

Raporti vjetor 2016 i Mekanizmit përcjellës ka shpërfaqur sukseset e arritura në zbatim të planit strategjik dhe planit të veprimit 2016-2018, të cilat tregojnë ngritje të lartë në zgjidhjen e lëndëve për veprat penale karakteristike në raport me lëndët e pranuar, të reja.

Raporti vjetor 2016 i Mekanizmit përcjellës ka shpërfaqur sfidën e ngarkesës me lëndët e Drogave, të cilat rezultojnë me numrin më të lartë të ngarkesës me lëndë në raport me lëndët e veprave tjera karakteristike, që përbëjnë Mekanizmin përcjellës ndërinstitucional. Andaj, në reflektim të kësaj sfide, të adresuar edhe në takimin e KPK-së të datës 10 mars 2016, përmes këtij raporti hulumtues kemi analizuar ngarkesën me lëndë të drogave, prokuroritë të cilat e kanë ngarkesën më të lartë me lëndët e kësaj natyre si dhe kemi bërë planifikimin strategjik për zvogëlimin e ngarkesës me lëndët e kësaj natyre.

HYRJE

Qëllimi kërkimor

Qëllimi kërkimor konsiston në rishikimin e gjendjes së lëndëve për veprat penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës, për katër vitet të funksionimit të këtij sistemi, në kontekstin e identifikimit dhe njohjes së ngarkesës me lëndë me qëllim të planifikimit për ngritjen e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të pranuar, të reja.

Objekti kërkimor

Objekt i këtij raporti janë lëndët (*Kallëzimet penale me persona dhe Informatat PPN me persona*) për veprat penale karakteristike të Armët, Drogat, Kontrabandimi me migrant, Krimi organizuar, Korrupsioni, Shpërlarja e parasë, Trafikimi me qënje njerëzore, Krimet ekonomike dhe Nxitja e urrejtjes.

Pyetjet kërkimore

1. Cili është niveli i zgjidhjes së lëndëve të pranuar, për veprat penale të mekanizmit përcjellës?
2. Cili është niveli i ngarkesës me lëndë për veprat penale, sipas prokurorive?
3. Cilat janë veprat penale të cilat përbëjnë numrin më të lartë të lëndëve?
4. Cilat prokurori kanë ngarkesën më të lartë të lëndëve me ngarkesën më të lartë?
5. Si do të jetë ngarkesa me lëndë në fund të vitit 2017 (parashikimi nga mesatarja)
6. Cila është politika e duhur për zvogëlimin e ngarkesës me lëndë, në prokuroritë respektive ?
7. Cilat vepra penale mund apo duhet të inkorporohen në Mekanizmin përcjellës.

Metodat kërkimore

Objekti kërkimor dhe pyetjet kërkimore kanë përcaktuar përdorimin e metodës së përzier kërkimore (Metoda sasiore dhe metoda cilësore).

Metoda sasiore: Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metoda sasiore, përmes së cilës janë identifikuar problemet e ngarkesës me lëndë dhe zgjidhjen e lëndëve të reja, si dy variabla të konstatimit të nivelit të efikasitetit në sistemit prokurorial në luftimin e kriminalitetit të natyrës së veprave penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës.

Metoda cilësore: Meqenëse identifikimi i sfidave është realizuar përmes metodës sasisore, përdorimi i metodës cilësore konsiston në njohjen e problemit dhe gjetjen e alternativave për zgjidhjen e tyre.

1. ANALIZA MBI EFIKASITETIN NË ZGJIDHJEN E LËNDËVE TË PRANUARA ME QËLLIM TË IDENTIFIKIMIT TË NGARKESËS ME LËNDË.

Nga analiza krahasimore e zgjidhjes sasiore të të gjitha lëndëve (për veprat penale karakteristike përgjatë 4 viteve) në raport me lëndët e pranuar gjatë viteve respektive, konstatohet se në mënyrë konstante, nga viti në vit, është rritur efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve të pranuar të veprat penale karakteristike (shih figurën 1). Nga të dhënat e analizuara, të trajtuara në shtojcë, rezulton se; në vitin 2016, për herë të parë, është arritur të tejkalohet kuota prej 100% e rasteve të zgjidhura për persona në raport me numrin e rasteve të pranuar për persona në atë vit.




Figura 1

Nga analiza krahasimore, sipas viteve, e zgjidhjes sasiore të lëndëve në raport me lëndët e pranuar në bazë të katër treguesve të matjes: (1) Kallëzimeve penale (shih figurën 2-a) me (2) Persona (shih figurën 2-b) dhe (3) Informatave PPN (shih figurën 2-c) me (3) persona (shih figurën 2-ç), rezulton me ngritje të efikasitetit në vitin 2016, në lëndët që kanë të bëjë me:

- Kallëzimet penale:** Kontrabandimi me migrant; Krimi organizuar, Korrupsioni, Shpëlarja e parasë dhe krime ekonomike.
- Personat në kallëzime penale:** Kontrabandimi me migrant; krimi organizuar, Korrupsioni, Shpëlarja e parasë, Krimet ekonomike dhe Nxitja urrejtjes.
- Informatat PPN:** Kontrabandimi me migrant; Krimi organizuar dhe Trafikimi me qënje njerëzore.
- Personat në Informatat PPN:** Kontrabandimi me migrant dhe Trafikimi me qënje njerëzore.

RAPORTI KRAHASIMOR (SASIOR DHE NË PËRQINDJE) I KALLËZIMEVE PENALE TË PRANUARA DHE TË ZGJIDHURA

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE		2013			2014			2015			2016		
		Të pranuara	Të zgjidhura		Të pranuara	Të zgjidhura		Të pranuara	Të zgjidhura		Të pranuara	Të zgjidhura	
			Nr.	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%
1	Armët	38	19	50	23	27	117.39	13	12	92.31	13	8	57.14
2	Drogat	374	257	68.72	511	350	68.49	438	339	77.40	438	455	62.62
3	Kontrabandimi me migrant	47	29	61.70	56	35	62.50	39	33	84.62	39	21	123.52
4	Krimi organizuar	11	2	18.18	22	8	36.36	14	8	57.14	14	13	325
5	Korrupsioni	436	314	72.02	503	444	88.27	412	412	100	412	468	106.84
6	Shpërlarja parasë	18	25	138.89	11	14	127.27	9	7	77.78	9	6	150
7	Trafikimi me qënje njerëzore	45	33	73.33	33	22	66.67	25	17	68	25	25	78.125
8	Krimet ekonomike	-	-	-	617	451	73.09	379	276	72.82	379	407	118.65
9	Nxitja urrejtjes	-	-	-	-	-	-	10	5	50	10	5	50%
GJITHSEJ		969	679	70.07%	1776	1351	76.06%	1339	1109	82.82%	1583	1408	88.94%

Figura 2-a

RAPORTI KRAHASIMOR (SASIOR DHE NË PËRQINDJE) I RASTEVE TË PRANUARA DHE TË ZGJIDHURA PËR PERSONA (NË KALLËZIMET PENALE)

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE		2013			2014			2015			2016		
		Të pranuara	Të zgjidhura		Të pranuara	Të zgjidhura		Të pranuara	Të zgjidhura		Të pranuara	Të zgjidhura	
			Nr.	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%
1	Armët	70	38	54.29	44	63	143.18	19	29	152.63	25	21	84
2	Drogat	616	429	69.64	793	552	69.61	654	553	84.56	991	636	64.17
3	Kontrabandimi me migrant	129	112	86.82	118	97	82.20	86	91	105.81	40	55	137.50
4	Krimi organizuar	92	9	9.78	165	125	75.76	156	113	72.44	83	185	222.89
5	Korrupsioni	1046	665	63.58	1011	1011	100	860	919	106.86	849	1164	137.10
6	Shpërlarja parasë	36	116	332.22	25	37	148	27	15	55.56	7	17	170
7	Trafikimi me qënje njerëzore	111	148	133.33	93	56	60.22	67	63	94.03	76	72	94.73
8	Krimet ekonomike				737	517	70.14	525	338	64.38	487	512	105.13
9	Nxitja urrejtjes							38	29	76.31	6	16	266.66
Gjithsej		2100	1517	72.23%	2986	2458	82.31%	2432	2150	88.40%	2564	2678	104.44%

Figura 2-b

RAPORTI KRAHASIMOR (SASIOR DHE NË PËRQINDJE) I INFORMATAVE PPN TË PRANUARA DHE TË ZGJIDHURA

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE		2013			2014			2015			2016		
		Të pranuar	Të zgjidhura		Të pranuar	Të zgjidhura		Të pranuar	Të zgjidhura		Të pranuar	Të zgjidhura	
			Nr.	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%
1	Armët	3	0	0	-	-	-	1	1	100	-	-	-
2	Drogat	13	7	53.84	21	12	57.14	9	2	22.22	30	19	63.33
3	Kontrabandimi me migrant	6	2	33.33	10	1	10	8	2	25	1	3	300
4	Krimi organizuar	1	0	0	9	3	33.33	4	4	100	3	3	100
5	Korrupsioni	165	81	49.09	184	143	77.71	266	151	56.76	433	274	63.27
6	Shpërlarja parasë	30	15	50	14	11	78.57	17	12	70.58	21	6	28.57
7	Trafikimi me qënje njerëzore	8	5	62.50	9	4	44.44	11	3	27.27	3	5	166.66
8	Krimet ekonomike	-	-	-	36	12	33.33	110	72	65.45	155	105	67.74
9	Nxitja urrejtjes	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ		226	110	48.67%	283	186	65.72%	426	247	57.98%	646	415	64.24%

Figura 2-c

RAPORTI KRAHASIMOR (SASIOR DHE NË PËRQINDJE) I RASTEVE TË PRANUARA DHE TË ZGJIDHURA PËR PERSONA (NË INFORMATAT PPN)

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE		2013			2014			2015			2016		
		Të pranuar	Të zgjidhura		Të pranuar	Të zgjidhura		Të pranuar	Të zgjidhura		Të pranuar	Të zgjidhura	
			Nr.	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%
1	Armët	26	0	0	-	-	-	1	1	100	-	-	-
2	Drogat	21	8	38.09	30	12	40	16	4	25	34	20	58.82
3	Kontrabandimi me migrant	23	4	17.39	23	2	8.69	15	2	13.33	1	5	500
4	Krimi organizuar	4	0	0	24	7	29.16	8	5	62.5	15	13	86.66
5	Korrupsioni	331	133	40.18	374	281	75.13	540	336	62.22	705	457	64.82
6	Shpërlarja parasë	48	25	52.08	33	20	60.60	37	20	54.05	56	15	26.78
7	Trafikimi me qënje njerëzore	13	6	46.15	12	7	58.33	18	8	44.44	4	7	175
8	Krimet ekonomike	-	-	-	37	12	32.43	113	74	65.48	167	113	67.66
9	Nxitja urrejtjes	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		466	176	37.76%	533	341	63.97%	748	450	60.16%	982	630	64.15%

Figura 2-ç

2. TRENDI I PRANIMIT TË KALLËZIMEVE PENALE ME PERSONA

Në vitin 2016 janë pranuar 244 apo 18.22% kallëzime penale dhe 132 apo 5.42% persona më shumë në raport me vitin 2015 (shih figurën 3):




Figura 3

3. INDEKSI I NGARKESËS ME LËNDË

Në bazë të analizës, objekt të këtij raporti, rezulton se veprat penale karakteristike të cilat përbëjnë ngarkesën më të lartë në vitin 2016 (shih figurën 4), sipas lëndës janë:

- **Kallëzimet penale** - (1) Drogat, (2) Krimet ekonomike dhe (3) Korrupsioni;
- **Personat** - (1) Korrupsioni, (2) Drogat, (3) Krimet ekonomike dhe (4) Krimi organizuar
- **Informatat PPN** - (1) Korrupsioni dhe (2) Krimet ekonomike,
- **Personat në informatat PPN** - (1) Korrupsioni dhe (2) Krimet ekonomike.




Figura 4

4. NGARKESA ME LËNDË NË VITIN 2016 DHE NGARKESA E PRETENDUAR ME LËNDË NË VITIN 2017

Në bazë të analizës, objekt të këtij raporti, sipas dy kriterëve; (1) Ngarkesës më të lartë me lëndë, sipas llojit të veprave penale në vitin 2016, dhe (2) Ngarkesës më të lartë me lëndë, sipas metodës së përlllogaritjes së mostrës mesatare, sipas llojit të veprave penale në vitin 2017, rezultojnë se ngarkesën më të lartë me lëndë, për veprat penale të njëjta, në fund të vitit 2017 pretendohet të kenë veprat penale të (1) Drogave, (2) Korrupsionit dhe (3) Krimeve ekonomike (shih figurën 5).




Figura 5

5. IDENTIFIKIMI I PROKURORIVE DHE LLOJIT TË VEPRAVE PENALE QË KRIJOJNË NGARKESËN ME LËNDË

Në bazë të analizës, objekt të këtij raporti, ngarkesën më të lartë me lëndë për veprat penale të Drogave, Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike rezultojnë të kenë Prokuroritë Themelore në Prishtinë dhe Mitrovicë (shih figurën 6):




Figura 6

6. PLANIFIKIMI I ZVOGËLIMIT TË NGARKESËS ME LËNDË NË DINAMIKËN E NORMËS ORIENTUESE

6.1 PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË

Në bazë të analizës, objekt të këtij raporti, konstatohet se Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngarkesën më të madhe me lëndë (në vitin 2016), në raport me prokuroritë tjera, për veprat penale të Drogave (478 lëndë me 963 persona), Korrupsionit (223 lëndë me 655 persona) dhe Krimeve ekonomike (166 lëndë me 253 persona).

PROPOZIM: Këshilli Prokurorial i Kosovës, të bëjë plotësim ndryshimin e planit strategjik dhe planit të veprimit 2016-2018, duke inkorporuar në planin strategjik trajtimin e lëndëve të Drogave, si dhe duke shtuar në një (1) prokurorë në DKR (të bëhen 7 prokurorë) për trajtimin e lëndëve të korrupsionit, ndërsa dy (2) prokurorë nga DKR-ja t'i shtohen njësitit për trajtimin e lëndëve të grupit të drogave, përveç nenit 275 të cilat do të trajtohen nga tre (3) prokurorët aktual të DP në Njësit (*shih figurën 7*).

Njësitit në PTh Prishtinë dhe trajtimi i lëndëve sipas kompetencës do të ketë këtë përbërje:

- Shtatë (7) prokurorë të DKR-së do të trajtojnë lëndët e Korrupsionit (përveç nenit 437);
- Dy (2) prokurorë të DKR-së do të trajtojnë lëndët e Drogave (përveç nenit 275);
- Tre (3) prokurorë të DP-së do të trajtojnë lëndët e krimeve ekonomike, lëndët e korrupsionit nga neni 437 dhe lëndët e drogave nga neni 275.

NJËSITI	LËNDËT	Numri prokurorëve	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
KORR	K.P (PP)	7	DKR	190	133	323	231-31=200	123	133	256	231-31=200		56
		3	DP	33	24	57	99-9=90	-33					
	INFO (PPN)	6	DKR	343	128	471	31X8=248	223	128	351	31X8=248		103
		3	DP	61	23	84	9X8=72	12	23	35	9X8=72		-37
E	K.P (PP)	3	DP	166	64	230	759-39=720	-490					
	INFO (PPN)			253	27	280	39X8=312	-32					
DR	K.P (PP)	2	DKR	106	82	188	132	56	82	138	132		6
		3	DP	372	176	548	759	-211					

Figura 7

6.2 PROKURORIA THEMELORE NË MITROVICË

Në bazë të analizës, objekt të këtij raporti, konstatohet se Prokuroria Themelore në Mitrovicë është prokuroria e dytë (pas PTh. Prishtinës), me ngarkesën më të madhe me lëndë, për veprat penale të Drogave (131 lëndë me 195 persona), Korrupsionit (82 lëndë me 192 persona) dhe Krimeve ekonomike (153 lëndë me 229 persona) në vitin 2016, e të cilat janë objekt i trajtimit të pretenduar në vitin 2017.

PROPOZIM: Këshilli Prokurorial i Kosovës, në kontekstin e krijimit të politikave strategjike, e në këtë rast për trajtimin efikas të lëndëve të Drogave në PTh. Mitrovicë, të bëjë plotësim ndryshimin e Planit strategjik 2016-2018 për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, duke përcaktuar që:

1. Të caktohen dy (2) prokurorë nga DKR, të cilët ekskluzivisht, në bazë të normës orientuese, do të trajtojnë lëndët e Korrupsionit në PTh Mitrovicë, të cilët deri në fund të vitit 2018 do të zvogëlojnë ngarkesën me lëndë (shih figurën 8);

	KORRUPSIONI	Numri prokurorë	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
1	Kallëzime penale	2	DKR	82	38	120	66	54	38	92	66	26	
2	Informata PPN			55	18	73	48	25	18	43	48	-5	

Figura 8

2. Të caktohet një (1) prokuror në PTh Mitrovicë, i cili ekskluzivisht, në bazë të normës orientuese, deri në fund të vitit 2018 do të trajtonte dhe zvogëlonte ngarkesën me lëndët e Krimeve ekonomike dhe lëndët Drogave nga neni 275 i Kodit Penal (shih figurën 9);

	KRIMET EKONOMIKE DHE DROGAT NË DEPARTAMENTIN E PËRGJITHSHËM	Numri prokurorë	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
1	Krimet ekonomike	1	DP	153	82	235	150	85	82	167	150	17	
2	Drogat-neni 275			93	63	156	103	53	63	116	103	13	
	Gjithsej:			246	145	391	253	138	145	273	253	30	

Figura 9

3. Të caktohen dy (2) prokurorë në Departamentin për krime të rënda të PTh. Mitrovicës, për trajtimin, ekskluzivisht, e lëndëve të Drogave nga nenet 273, 274, 276, 277, 278, 279 dhe 280 të Kodit Penal. Këta dy prokurorë deri në fund të vitit 2017, do të zvogëlonin ngarkesën me lëndë të Drogave (shih figurën 10).

	DROGAT	Numri prokurorë	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
1	Kallëzime penale	2	DKR	38	26	64	66	-2					

Figura 10

7. IDENTIFIKIMI I VEPRAVE PENALE TË CILAT DUHET TË INKORPOROHEN NË GRUPIN E TRAFIKIMIT ME QËNJIE NJERËZORE

Mekanizmi përcjellës ndërinstitucional është krijuar në vitin 2013, dhe strukturimi i tij është realizuar në bazë të kategorizimit dhe klasifikimi të veprave penale karakteristike. Përveç grupeve tjera është krijuar edhe grupi i veprave penale të Trafikimit me njerëz, me vetëm një vepër penale nga neni 171 i Kodit Penal të Kosovës. Në raportet periodike të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional në vazhdimësi janë pasqyruar të dhënat për ngarkesën, pranimin dhe zgjidhjen e lëndëve për veprën penale të Trafikimit me njerëz nga neni 171 i Kodit Penal të Kosovës. Mirëpo, në bazë të normës së përcaktuar në nenin 171, paragrafi 6 me nënparagrafët 6.1 dhe 6.2 rezulton se edhe gjashtë (6) vepra penale i përkasin trafikimit me qënje njerëzore. Në kuadër të raportimeve periodike, Koordinatori për trafikimin me qënje njerëzore në vazhdimësi ka raportuar për shtatë (7) veprat penale të trafikimit me qënje njerëzore. Andaj, në bazë të udhëzimit dhe kërkesës së bazuar të koordinatorit për veprat penale të trafikimit me qënje njerëzore, kemi konstatuar arsyeshmërinë dhe nevojën e inkorporimit të gjashtë (6) veprave tjera në kuadër të kategorizimit të grupit të veprave penale të trafikimit me qënje njerëzore në mekanizmin përcjellës.

Arsyetimi: Paragrafi 6 i nenit 171, për qëllim të nenit 171 thekson se shprehet në vazhdim kanë këtë kuptim, citoj:

6.1 Shprehja “trafikim me njerëz” nënkupton rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.

a. Shprehja “Shfrytëzim” ashtu siç është përdorur në nën-paragrafin 6.1. të këtij paragrafi, përfshin, por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave.

Andaj, në këtë kontekst është parashtruar nevoja dhe domosdoshmëria e inkorporimit edhe të gjashtë (6) veprave tjera penale në grupin e veprave penale të Trafikimit me qënje njerëzore në mekanizmin përcjellës ndërinstitucional, që kanë për qëllim shfrytëzimin e viktimave për shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve; shfrytëzimin e pornografisë; shfrytëzimin e formave tjera të shfrytëzimit seksual, shfrytëzimin e lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, robërinë dhe transplantimin ose heqjen e organeve apo qelizave njerëzore.

Si përfundim, konstatojmë se në kuadër të grupit të veprave penale të trafikimit me njerëz, krahas nenit 171 të Kodit Penal, duhet të inkorporohen edhe këto gjashtë (6) vepra penale: (1) Neni 169 “Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar”, (2) Neni 172 “Fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz”; (3) Neni 231 “Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit”, (4) Neni 235 “Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet”; (5) Neni 265 “Transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore” dhe (6) Neni 246 “Martesa e detyruar”, në rastet kur ka elemente të trafikimit.

8. KONKLUZIONE

1. Lëndët e (1) Drogave, (2) Krimeve ekonomike dhe (3) Korrupsioni, përbëjnë ngarkesën më të lartë me lëndë në kuadër të veprave penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës.
2. (1) Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe (2) Prokuroria Themelore në Mitrovicë rezultojnë të kenë ngarkesën më të lartë me lëndët e Drogave, Krimeve ekonomike dhe Korrupsionit;
3. Ngarkesën më të lartë me lëndë, në mekanizmin përcjellës, e përbëjnë lëndët e Drogave në (1) Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe (2) Prokurorinë Themelore në Mitrovicë;
4. Zbatimi i planit strategjik dhe planit të veprimit 2016-2018 nga Njësiti në PTh. Prishtinë ka rezultuar me ngritjen e efikasitetit në zvogëlimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, mirëpo jo në përmasat e pritshmërisë së bazuar me Udhëzimin Administrativ për normën orientuese;
5. Konstatojmë se (1) Profilizimi i prokurorëve, (2) Planifikimi dinamik për zbatimin e normës orientuese duke përfshirë ndërlikueshmërinë e lëndëve si dhe (3) Mbikëqyrja e zbatimit të planit strategjik 2016-2018 duke përfshirë planifikimin dinamik, janë kriteret themelore përmes të cilave rritet efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve të pranuar të Drogave, Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike dhe realizohet zvogëlimi ngarkesës me lëndë veçanërisht në (1) Njësitin në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe (2) Prokurorinë Themelore në Mitrovicë;
6. Konstatojmë nevojën e ndryshimit të Udhëzimi administrativ për normën orientuese, respektivisht adresimin e ndërlikueshmërisë së lëndëve për disa vepra penale karakteristike si dhe adresimin e politikës strategjike të bazuar në parimin e ekonomizimit të procedurës përmes Institutit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë;
7. Konstatojmë nevojën e krijimit të një mekanizmi (një zyrtar dhe baza e të dhënave) për gjenerimin e të dhënave sasiore dhe në përqindje, në baza mujore, të arritshmërisë së normës orientuese për të gjithë prokurorët, duke përfshirë edhe kalkulimin e lëndëve të ndërlikuara, të cilëve i'u adresohet udhëzimi administrativ për normën orientuese.
8. Konstatojmë se për zbatimin e planit strategjik 2016-2018, dhe realizimin e qëllimit për zvogëlimin e ngarkesës me lëndët e Drogave, Korrupsionit dhe krimeve ekonomike, deri në fund të periudhës kohore të vlefshmërisë së planit, nevojiten të realizohen këto masa:
 - i. Njësiti në PTh. Prishtinë të përbëhet nga shtatë (7) prokurorë nga DKR të për trajtimin e lëndëve të Korrupsionit, dy (2) prokurorë nga DKR të për trajtimin e lëndëve të Drogave dhe tre (3) prokurorë nga DP për trajtimin e lëndëve të Krimeve ekonomike, korrupsionit nga neni 437 dhe lëndëve të drogave nga neni 275.
 - ii. Në PTh. Mitrovicë të caktohen (me vendim) dy (2) prokurorë nga DKR për trajtimin e lëndëve të Korrupsionit, (2) Prokurorë nga DKR për trajtimin e lëndëve të Drogave dhe një (1) prokuror për trajtimin e lëndëve të Krimeve ekonomike, korrupsionit nga neni 437 dhe lëndëve të drogave nga neni 275.

9. REKOMANDIME

1. Plotësim ndryshimi i Planit strategjik dhe planit të veprimit 2016-2018 për ngritjen e efikasitet në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, duke inkorporuar edhe trajtimin e lëndëve të Drogave, duke adresuar edhe obligimin për mbikëqyrje;
2. Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ për normën orientuese, për të reflektuar ndaj rëndësisë së lëndëve me ndëlikueshmëri të lartë si dhe adresimin e parimit të ekonomizimit të procedurës përmes Institutit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë;
3. Krijimi i mekanizmit për administrimin dhe gjenerimin mujor të të dhënave mbi arritshmërinë e normës orientuese për çdo prokurorë, në zgjidhjen sasiore të lëndëve (në pajtim rekomandimin nr.2). Respektivisht caktimi i një (1) zyrtari dhe krijimi apo modifikimi i bazës/ave për regjistrimin e të dhënave mbi gjendjen dhe procedimin e të gjitha lëndëve të trajtuara duke përfshirë edhe kalkulimin e lëndëve të ndërlikuara (në pajtim rekomandimin nr.2) për të pasqyruar realizimin e normës orientuese. Të dhënat e gjeneruara do të kenë ndikim të shumëanshëm, duke përfshirë: (1) Ngritjen e llogaridhënies, (2) Përcaktimin e saktë të normës së arritur, (3) Vlerësimin e performancës së prokurorëve, (4) Realizimin e planit strategjik 2016-2018 etj.
4. Për zbatimin e politikave strategjike përmes realizimit të planit strategjik dhe planit të veprimit 2016-2018 (në pajtim me rekomandimin nr.1), Këshilli Prokurorial i Kosovës të vendos, si në vijim:
 - i. **NJËSITI-t në Prokurorinë Themelore në Prishtinë** t'i shtohen:
 - Një (1) prokuror nga DKR për trajtimin e lëndëve të Korrupsionit (nga 6 prokurorë aktualisht, në 7 prokurorë);
 - Dy (2) prokurorë nga DKR për trajtimin ekskluzivisht të lëndëve të Drogave, përveç lëndëve nga neni 275;
 - Ndërsa tre (3) prokurorët e DP-së në Njësit, përveç trajtimit të lëndëve të krimeve ekonomike dhe korrupsionit nga neni 437, të trajtojnë edhe lëndët e Drogave nga neni 275;
 - ii. **Në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë**, të caktohen pesë (5) prokurorë për trajtimin ekskluzivisht të ngarkesës më lëndët e Drogave, Korrupsionit dhe krimet ekonomike, respektivisht:
 - Dy (2) prokurorë të DKR për trajtimin ekskluzivisht të lëndëve të Korrupsionit;
 - Dy (2) prokurorë të DKR për trajtimin ekskluzivisht të lëndëve të Drogave;
 - Një (1) prokurorë nga DP për trajtimin ekskluzivisht të lëndëve të krimeve ekonomike, korrupsionit nga neni 437 dhe lëndëve të Drogave nga neni 275;
5. Në pajtim me rekomandimet në pikën 4.i, Prokurorët e Njësitit në Prishtinë të zbatojnë planin e veprimit që adreson dinamikën kohore të zgjidhjes së lëndëve, për prokurorët që trajtojnë lëndët e kompetencës së Departamentit për Krime të Rënda dhe Departamentit të përgjithshëm (figurat P1, P2, P3). Mbikëqyrja e zbatimit të këtij plani të realizohet nga Kryeprokurori i PTh. Prishtinë, Komisioni mbikëqyrës dhe Koordinatori nacional për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

12 PROKURORË NË NJËSIT (9 DKR + 3DP)		Numri prokurorëve	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
KORR	K.P (PP)	7	DKR	190	133	323	231-31=200	123	133	256	231-31=200	56	
		3	DP	33	24	57	99-9=90	-33					
	INFO (PPN)	6	DKR	343	128	471	31X8=248	223	128	351	31X8=248	103	
		3	DP	61	23	84	9X8=72	12	23	35	9X8=72	-37	
E	K.P (PP)	3	DP	166	64	230	759-39=720	-490					
	INFO (PPN)			253	27	280	39X8=312	-32					
DR	K.P (PP)	2	DKR	106	82	188	132	56	82	138	132	6	
		3	DP	372	176	548	759	-211					

Figura P1: Plani dinamik i Njësitit në PTh. Prishtinë

TRE (3) PROKURORË TË DP-së në NJËSIT		Numri prokurorëve	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
KORR	KALLËZIME PENALE	3	DP	33	24	57	99- 9=90	-33 ndërlikuara=66 norma KORR = 759 E/DR (neni 275)					
	INFORMATA PPN			61	23	84	9X8=72	12	23	35	72	-37	
E	KALLËZIME PENALE			166	64	230	759-39=720	-490					
	INFORMATA PPN			253	27	280	39X8=312	-32					
DR	KALLËZIME PENALE			372	176	548	759	-211					

Figura P2: Plani dinamik për zgjidhjen e lëndëve nga prokurorët e DP-së në NJËSIT

TRE (3) PROKURORË TË DP-së në NJËSIT		Numri prokurorëve	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
E + DR	KALLËZIME PENALE	3	DP	538	240	778	759-39=720	58	240	298	759-39=720		
E	INFORMATA PPN			253	27	280	39X8=312	-32					

Figura P3: Përlllogaritja sipas normës orientuese vjetore të prokurorëve në DP

9. Në pajtim me rekomandimet në pikën 4.ii, Prokurorët e caktuar të PTh. Mitrovicë të zbatojnë planin e veprimit që adreson dinamikën kohore të zgjidhjes së Departamentin e Krimeve të Rënda dhe Departamentin e përgjithshëm (figura M1). Mbikëqyrja e zbatimit të këtij plani të realizohet nga Kryeprokurori i PTh. Prishtinë, Komisioni mbikëqyrës dhe Koordinatori nacional për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

	PTH. MITROVICË	Numri prokurorëve	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
1	KORR	2	DKR	82	38	120	66	54	38	92	66	26	
2	E	1	DP	153	82	235	150	85	82	167	150	17	
	DR- neni 275			93	63	156	103	53	63	116	103	13	
	E & DR- neni 275			246	145	391	253	138	145	273	253	30	
3	DR	2	DKR	38	26	64	66	-2					

Figura M1: Plani dinamik i punës së prokurorëve të caktuar në PTh Mitrovicë

10. Nëse PTh Mitrovicë nuk ka numër të mjaftueshëm të prokurorëve për të realizuar obligimet e planit strategjik, do të ishte e dëshirueshme që KPK-ja të transferoj një numër të nevojshëm të prokurorëve nga prokuroritë tjera në prokurorinë e Mitrovicës).
11. Obligohen prokurorët të cilët do të trajtojnë lëndët nga veprat penale karakteristike të mekanizmit përcjellës që të zbatojnë procedurat e evidentimit të gjitha veprimeve procedurale në formularin unik të krijuar enkas për këto lloje të veprave penale karakteristike si dhe regjistrimin e të dhënave në bazën e të dhënave Krim/KORR të mekanizmit përcjellës.
12. Komisioni mbikëqyrës të mbikqyrë zbatimin e planit strategjik, të mbledh të dhënat dhe të raportoj në KPK lidhur me gjendjen e lëndëve të Korrupsionit, Krimeve ekonomike dhe Drogave,
13. Koordinatorin nacional, si instrumenti i dytë mbikëqyrës për zbatimin e planit strategjik 2016-2018 të raportoj në KPK për të dhënat lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, përmes veprave penale objekt të planit strategjik 2016-2018.
14. Kryesuesi i KPK-së së bashku me përgjegjësit e Policisë së Kosovës dhe Inspektoriatit Policor të Kosovës të diskutojnë dhe vendosin për zgjerimin e grupit të veprave penale të trafikimit me njerëz në mekanizmin përcjellës.
15. Pas vendimit pozitiv nga rekomandimi nr.14, Kryesuesi i KPK-së të autorizojë menaxherin e zyrës së statistikave, në cilësinë e krijuesit të bazës së të dhënave të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional që në bashkëpunim me koordinatoren e veprave penale të trafikimit me njerëz (Prokurorin nga Prokuroria e shtetit), të inkorporojnë në kuadër të grupit të veprave penale të trafikimit me njerëz edhe gjashtë (6) vepra penale nga neni 169, 231, 235, 265, 246, ndërsa veprën penale nga neni 172, e cila është në kuadër të mekanizmit përcjellës si vepër e veçantë, të zhvendos në kuadër të grupit të veprave penale të Trafikimit me qenje njerëzore. Gjithashtu, Kryesuesi i KPK-së të autorizoj krijuesin e bazës së të dhënave që të hartoj dhe zbatoj planin për njoftimin, trajnimin dhe realizimin e

ndryshimeve (nga rekomandimi nr.15) nga ana prokurorëve dhe zyrtarëve (*shëfave të shkrimoreve*) nëpër të gjitha prokuroritë themelore dhe PSRK. Për më tej, për të gjitha lëndët e grupit të trafikimit me qënje njerëzore të zbatohen udhëzimi për etiketimin lëndës me akronimin (TNJ) si dhe të respektohet evidentimi i veprimeve procedurale në formularin unik, i cili inkorporohet në të gjitha lëndët e veprave penale karakteristike, me qëllim të përditësimit të informacioneve në bazën e të dhëanave të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional.

16. Këshilli Prokurorial i Kosovës, pas miratimit të rekomandimeve të këtij raporti të caktoj një antar të saj, për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe të caktoj afatin për raportim lidhur me zbatueshmërinë e rekomandimeve.

@ Raporti kërkimor (*hulumtues*) 2017

Pronësia: Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Hartuesi: Besim Kusari: Koordinator nacional i “Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional”.

SHTOJCA

KJO SHTOJCË VLEN VETËM PËR ANTARËT E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS, E JO PËR PUBLIKIM.

ANTARËT E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS PËRMES KËSAJ SHTOJCE KONSTATOJNË SAKTËSINË E REZULTATEVE TË PASQYRUARA NË RAPORT.

SHTOJCA NË VAZHDIM PASQYRON:

1. TABELAT PUNUESE
2. TABELAT ANALITIKE
3. METODOLOGJITË E PËRDORURA PËR GJETJEN E REZULTATAVE;
4. ANALIZËN SASISORE
5. ANALIZËN CILËSORE
6. IDENTIFIKIMIN E SFIDAVE
7. PLANIFIKIMIN STRATEGJIK PËR ZGJIDHJEN E SFIDAVE

PËRMBAJTJA E SHTOJCËS:

1	Gjendja e lëndëve sipas veprave penale në vitet 2013 – 2016.....	19
2	Trendi i zgjidhjes së lëndëve të pranuar (kallëzime penale me persona dhe Informata PPN me persona)- në përqindje sipas viteve.....	20
3	Përlllogaritja e ngarkesës 2016, pranimi, zgjidhjes dhe ngarkesa së retenduar në 2017...	21
4	Identifikimi i prokurorive me ngarkesën më e lartë me lëndë.....	24
5	Metodologjia e hulumtimit dhe tabelat punuese për realizimin e parashikimit të ngarkesës me lëndë të Drogave, në fund të vitit 2017.....	26
6	Metodologjia e hulumtimit dhe tabelat punuese për realizimin e parashikimit të ngarkesës me lëndë të Korrupsionit, në fund të vitit 2017.....	27
7	Metodologjia e hulumtimit dhe tabelat punuese për realizimin e parashikimit të ngarkesës me lëndë të Krimeve ekonomike, në fund të vitit 2017.....	28
8	Ngritja e performancës në zgjidhjen e kallëzimeve penale.....	29
	8.1 Performanca e lartë.....	29
	8.2 Performanca e ulët.....	29
9	Analiza e performancës së lartë.....	29
10	Analiza e performancës së ulët.....	32
11	Performanca në zgjidhjen e rasteve për persona.....	33
	11.1 Performanca e lartë.....	33
	11.2 Performanca e ulët.....	33
12	Analiza mbi ngritjen e efikasitetit në zgjidhjen e rasteve për persona.....	33
13	Identifikimi i problemit dhe propozimi për zgjidhje: PTh. Prishtinë.....	35
14	Identifikimi i problemit dhe propozimi për zgjidhje: PTh. Mitrovicë.....	37
15	Planifikimi për ngritjen e efikasitetit në PTh. Mitrovicë.....	38
	15.1 Korrupsioni.....	38
	15.2 Krimet ekonomike.....	38
	15.3 Drogat.....	39

1.GJENDJA E LËNDËVE SIPAS VEPRAVE PENALE NË VITET 2013 - 2016 (Figura 1)

			TË BARTURA		TË PRANUARA		NË PUNË		TË ZGJIDHURA		TË MBETURA	
			A		B		C (A+B)		Ç		D (C-Ç)	
			Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
1	ARMËT	2013	10	32	38	70	48	102	19	38	29	64
		2014	30	73	23	44	53	117	27	63	26	54
		2015	29	63	13	19	42	82	12	29	30	53
		2016	30	53	14	25	44	78	8	21	36	57
2	DROGAT	2013	169	280	374	616	543	896	257	429	286	467
		2014	284	469	511	793	795	1262	350	552	445	710
		2015	467	740	438	654	905	1394	339	553	566	841
		2016	555	829	726	991	1281	1820	455	636	828	1189
3	KONTRABAND ME MIGRANT	2013	19	94	47	129	66	223	29	112	37	111
		2014	38	106	56	118	94	224	35	97	59	127
		2015	60	129	39	86	99	215	33	91	66	124
		2016	63	118	17	40	80	158	21	55	56	103
4	KRIMI I ORGANIZUAR	2013	16	118	11	92	27	210	2	9	25	201
		2014	25	223	22	165	47	388	8	125	39	263
		2015	41	311	14	156	55	467	8	113	47	354
		2016	49	445	4	83	53	528	13	185	40	343
5	KORRUPSIONI	2013	342	1115	436	1046	778	2161	314	665	464	1496
		2014	473	1558	503	1011	976	2569	444	1011	532	1558
		2015	538	1699	412	860	950	2559	412	919	538	1640
		2016	477	1563	438	849	915	2412	468	1164	447	1248
6	SHPËRLARJA E PARASË	2013	38	171	18	36	56	207	25	116	31	91
		2014	32	94	11	25	43	119	14	37	29	82
		2015	30	83	9	27	39	110	7	15	32	95
		2016	31	76	4	7	35	83	6	17	29	66
7	TRAFIKIMI ME QËNJIE NJERËZORE	2013	22	122	45	111	67	233	33	148	34	85
		2014	33	88	33	93	66	181	22	56	44	125
		2015	43	131	25	67	68	198	17	63	51	135
		2016	50	134	32	76	82	210	25	72	57	138
8	KRIMET EKONOMIKE	2013										
		2014	322	403	617	737	939	1140	451	517	488	623
		2015	482	613	379	525	861	1138	276	338	585	800
		2016	531	775	343	487	874	1262	407	512	467	750
9	NXITJA URREJTJES	2013										
		2014										
		2015	11	86	10	38	21	124	5	29	16	95
		2016	17	86	5	6	22	92	5	16	17	76
TOTALI:		2013	616	1932	969	2100	1585	4032	679	1517	906	2515
		2014	1237	3014	1776	2986	3013	6000	1351	2458	1662	3542
		2015	1701	3855	1339	2432	3040	6287	1109	2150	1931	4137
		2016	1803	4079	1583	2564	3386	6643	1408	2678	1977	3970
			857	2691	5667	10082	6524	12773	4547	8803	1977	3970

Figura 1

2.TRENDI I ZGJIDHJES SË LËNDËVE TË PRANUARA (KALLËZIME PENALE ME PERSONA DHE INFORMATAT PPN ME PERSONA)- NË PËRQINDJE SIPAS VITEVE:




Figura 2 (Armët)




Figura 3 (Drogat)




Figura 4 (Kontrabandimi me migrant)




Figura 5 (Krimi organizuar)




Figura 6 (Korrupsioni)




Figura 7 (Shpërlarja e parase)




Figura 7 (Trafikimi me qënje njerëzore)




Figura 8 (Krimet ekonomike)




Figura 9 (Nxitja urrejtjes)

3.PËRLLLOGARITJA E NGARKESËS 2016, PRANIMIT, ZGJIDHJES DHE NGARKESA SË RETENDUAR NË 2017 (Figura 10-a,b,c,ç)

KALLËZIME PENALE	Ngarkesa në fund të 2015	Ngarkesa në fund të 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjidhura (2015+2016)	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
ARMËT	30	36	33	21	10	11	44
DROGAT	566	828	697	582	397	185	882
KONTR.ME MIGRANT	66	56	61	56	27	29	90
KRIMI I ORGANIZUAR	47	40	43.5	23	11	12	55.5
KORRUPSIONI	538	447	492.5	425	440	-15	477.5
SHPËRLARJA PARASË	32	29	30.5	17	7	10	40.5
T. Q. NJERËZORE	51	57	54	38	21	17	71
KRIMET EKONOMIKE	585	467	526	361	341.5	-19.5	506
NXITJA URREJTJES	16	17	16.5	8	5	3	19.5
GJITHSEJ	1931	1977	1954	1646	1260	386	2340

Figura 10-a

PERSONA (NË KALLËZIMET PENALE)	Ngarkesa në fund të 2015	Ngarkesa në fund të 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjidhura (2015+2016)	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
ARMËT	53	57	55	19	16.5	+2.5	57.5
DROGAT	841	1189	1015	714.5	487.5	+227	1242
KONTR.ME MIGRANT	124	103	113.5	39.5	44	-4.5	109
KRIMI I ORGANIZUAR	354	343	348.5	48.5	96.5	-48	300.5
KORRUPSIONI	1640	1248	1444	630.5	788	-157.5	1286.5
SHPËRLARJA PARASË	95	66	80.5	8	12	-4	76.5
T. Q. NJERËZORE	135	138	136.5	50.5	44.5	+6	142.5
KRIMET EKONOMIKE	800	750	775	433	394	+39	814
NXITJA URREJTJES	95	76	85.5	8	10.5	-2.5	83
GJITHSEJ	4137	3970	4053.5	1951.5	1893.5	+58	4111.5

Figura 10-b

INFORMATAT PPN	Ngarkesa në fund të 2015	Ngarkesa në fund të 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjidhura (2015+2016)	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
ARMËT	4	4	4	0.5	0.5	0	4
DROGAT	30	42	36	19.5	10.5	+9	45
KONTR.ME MIGRANT	21	19	20	4.5	2.5	+2	22
KRIMI I ORGANIZUAR	10	11	10.5	3.5	3.5	0	10.5
KORRUPSIONI	399	700	549.5	349.5	212.5	+137	686.5
SHPËRLARJA PARASË	35	50	42.5	19	9	+10	52.5
T. Q. NJERËZORE	20	16	18	7	4	+3	21
KRIMET EKONOMIKE	65	172	118.5	132.5	88.5	+44	162.5
NXITJA URREJTJES	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	584	1014	799	536	331	+205	1004

Figura 10-c

PERSONA (NË INFORMATAT PPN)	Ngarkesa në fund të 2015	Ngarkesa në fund të 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjidhura (2015+2016)	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
ARMËT	26	26	26	0.5	0.5	0	26
DROGAT	53	68	60.5	25	12	+13	73.5
KONTR.ME MIGRANT	55	51	53	8	3.5	+4.5	57.5
KRIMI I ORGANIZUAR	26	29	27.5	11.5	9	+2.5	30
KORRUPSIONI	851	1201	1026	622.5	396.5	+226	1252
SHPËRLARJA PARASË	75	116	95.5	46.5	17.5	+29	124.5
T. Q. NJERËZORE	31	25	28	11	7.5	+3.5	31.5
KRIMET EKONOMIKE	68	181	124.5	140	93.5	+46.5	171
NXITJA URREJTJES	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	1185	1697	1441	865	540	+325	1766

Figura 10-ç

4.IDENTIFIKIMI I PROKURORIVE ME NGARKESËN MË E LARTË ME LËNDË:

DROGAT: Në bazë të parashikimit, të bazuar në kriterin e mesatares së fituar nga mbledhja e të dhënave për kallëzime penale me persona, Informata PPN me persona në vitet 2015 dhe 2016 për veprat penale të drogave (Figura 3), rezultojnë se në fund të vitit 2017 prokuroritë që do të kenë rritje të ngarkesës me lëndë në raport me vitin 2016. Prokuroria Themelore në Prishtinë do të ketë ngarkesën më të lartë, prej 499.5 apo **56.63%** të kallëzimeve penale dhe **725.5** apo **58.36%** të personave në raport me ngarkesën e përgjithshme (Figura 11).

#	PROKURORIA	KALLËZIME PENALE	PERSONA	INFORMATI PPN	PERSONA
1	PRISHTINË	499.5	725.5		
2	MITROVICË	153.5	226.5	11.5	21.75
3	PEJË			23	28.5

Figura 11

DROGAT	NGARKESA ME LËNDË NË VITIN 2016				NGARKESA ME LËNDË PARASHIKUAR NË VITIN 2017				Në vitin 2017 do të ketë më shumë / më pak lëndë se në vitin 2016			
	Kallëzime Penale	Persona	Informata PPN	Persona	Kallëzime Penale	Persona	Informata PPN	Persona	Kallëzime Penale	Persona	Informata PPN	Persona
	a	b	c	ç	d	dh	e	ë	1	2	3	4
PSRK	6	26	3	4	4	8.5	3	4	-2	-17.5	0	0
PRISHTINË	478	693	2	2	499.5	725.5	2	2	+21.5	+32.5	0	0
PRIZREN	67	90	3	4	75	99.5	2.5	3.5	8	+9.5	-0.5	-0.5
PEJË	52	63	16	21	58.5	71.5	23	28.5	+6.5	+8.5	+7	+7.5
GJILAN	22	23	3	5	22	23	3.25	5.5	0	0	+0.25	+0.5
MITROVICË	131	195	10	19	153.5	226.5	11.5	21.75	+22.5	31.5	+1.5	+2.75
FERIZAJ	56	71	4	12	52	62	4	12	-4	-9	0	0
GJAKOVË	16	28	1	1	17.5	26.5	1.75	1.75	+1.5	-1.5	+0.75	+0.75
GJITHSEJ	828	1189	42	68	882	1243	51	79	+54	+54	+9	+11

Figura 4

KORRUPSIONI: Në bazë të parashikimit, të bazuar në kriterin e mesatares së fituar nga mbledhja e të dhënave për kallëzime penale me persona, Informata PPN me persona në vitet 2015 dhe 2016 për veprat penale të Korrupsionit (Figura 12), rezultojnë se në fund të vitit 2017 prokuroritë që do të kenë të njëjtën ngarkesë me kallëzime penale në raport me vitin 2016. Prokuroria Themelore në Prishtinë do të kenë ngarkesën më të lartë, me **253** apo **52.98%** të kallëzimeve penale dhe **697.5** apo **54.21%** të personave në raport me ngarkesën e përgjithshme (Figura 13).

#	PROKURORIA	KALLËZIME PENALE	PERSONA	INFORMATI PPN	PERSONA
1	PRISHTINË	253	697.5	350.5	681
2	MITROVICË	89.5	201		

Figura 12

KORRUPSIONI	NGARKESA ME LËNDË NË VITIN 2016				NGARKESA ME LËNDË PARASHIKUAR NË VITIN 2017				Në vitin 2017 do të ketë më shumë / më pak lëndë se në vitin 2016			
	Kallëzime Penale	Persona	Informata PPN	Persona	Kallëzime Penale	Persona	Informata PPN	Persona	Kallëzime Penale	Persona	Informata PPN	Persona
	a	b	c	ç	d	dh	e	ë	1	2	3	4
PSRK	39	162	55	136	35	154.5	67.5	165	-4	-7.5	+12.5	+29
PRISHTINË	223	655	404	705	253	697.5	350.5	681	+30	+42.5	-53.5	-24
PRIZREN	27	69	43	64	30.5	73.5	43.5	63	+3.5	+4.5	+0.5	-1
PEJË	21	40	68	107	19	37.5	80	129	-2	-2.5	+12	+22
GJILAN	19	48	4	4	21.5	49.5	7	10	+2.5	+1.5	+3	+6
MITROVICË	82	192	55	79	89.5	201	63.5	92	+7.5	+9	+8.5	+13
FERIZAJ	17	47	50	78	11.5	40	51	82	-5.5	-7	+1	+4
GJAKOVË	19	35	21	28	17.5	33	23.5	30	-1.5	-2	+2.5	+2
GJITHSEJ	447	1248	700	1201	477.5	1286.5	686.5	1252	+30.5	+38.5	-13.5	+51

Figura 13

KRIMET EKONOMIKE: Në bazë të parashikimit, të bazuar në kriterin e mesatares së fituar nga mbledhja e të dhënave për kallëzime penale me persona, Informata PPN me persona në vitet 2015 dhe 2016 për veprat penale të Krimeve ekonomike (Figura 14), rezulton se në fund të vitit 2017 prokuroritë që do të kenë të njëjtën ngarkesë me kallëzime penale në raport me vitin 2016. Prokuroria Themelore në Prishtinë do të kenë ngarkesën më lartë me **262.5** apo **51.82%** të kallëzime penale dhe ndërsa Prokuroria Themelore në Mitrovicë do të ketë ngarkesën më të lartë me persona, respektivisht **298.5** apo **34.87%** të personave në raport me ngarkesën e përgjithshme (Figura 15).

#	PROKURORIA	KALLËZIME PENALE	PERSONA	INFORMATA PPN	PERSONA
1	PRISHTINË	262.5	271	70.5	75.5
2	MITROVICË	113.5	298.5		

Figura 14

KRIMET EKONOMIKE	NGARKESA ME LËNDË NË VITIN 2016				NGARKESA ME LËNDË - PARASHIKUAR NË VITIN 2017				Në vitin 2017 do të ketë më shumë / më pak lëndë se në vitin 2016			
	Kallëzime Penale	Persona	Informata PPN	Persona	Kallëzime Penale	Persona	Informata PPN	Persona	Kallëzime Penale	Persona	Informata PPN	Persona
	a	b	c	ç	d	dh	e	ë	1	2	3	4
PSRK	2	5	6	7	2	8	4	7	0	+3	-2	0
PRISHTINË	166	253	100	106	262.5	271	70.5	75.5	+96.5	+18	-29.5	-30.5
PRIZREN	51	68	5	5	62.5	58.5	4.5	6.5	+11.5	-9.5	-0.5	+1.5
PEJË	24	37	34	34	20.5	48.5	30	48	-3.5	+11.5	-4	14
GJILAN	4	32			2	30	-0.5	0	-2	-2	-0.5	0
MITROVICË	153	229			113.5	298.5	0	0	-39.5	+69.5	0	0
FERIZAJ	50	91	27	29	39	107	21.5	34	-11	+16	-5.5	+5
GJAKOVË	17	35			4.5	34.5	0	0	-12.5	-0.5	0	0
GJITHSEJ	467	750	172	181	506.5	856	130	171	+39.5	+106	-42	-10

Figura 15

5.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE TABELAT PUNUESE PËR REALIZIMIN E PARASHIKIMIT
TË NGARKESËS ME LËNDË TË DROGAVE, NË FUND TË VITIT 2017 (Figura 16-a,b,c,ç)

(DROGAT) KALLËZIME PENALE	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjdhurave	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	9	6	7.5	0.5	4	-3.5	4
PRISHTINË	312	478	395	191	86.5	104.5	499.5
PRIZREN	55	67	61	104	90	14	75
PEJË	37	52	44.5	65.5	51.5	14	58.5
GJILAN	4	22	13	51	42	9	22
MITROVICË	109	131	120	89.5	56	33.5	153.5
FERIZAJ	24	56	40	54	42	12	52
GJAKOVË	16	16	16	26.5	25	1.5	17.5
GJITHSEJ	566	828	697	582	397	185	882

Figura 16-a

(DROGAT) PERSONA (NË KALLËZIME PENALE)	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjdhurave	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	31	26	28.5	4.5	24.5	-20	8.5
PRISHTINË	461	693	577	280	131.5	148.5	725.5
PRIZREN	81	90	85.5	151	137	14	99.5
PEJË	42	63	52.5	84.5	65.5	19	71.5
GJILAN	4	23	13.5	67.5	58	9.5	23
MITROVICË	166	195	180.5	127	81	46	226.5
FERIZAJ	34	71	52.5	69	59.5	9.5	62
GJAKOVË	22	28	25	39	37.5	1.5	26.5
GJITHSEJ	841	1189	1015	822.5	594.5	228	1243

Figura 16-b

(DROGAT)	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjdhurave	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
INFORMATA PPN	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	3	3	3				3
PRISHTINË	2	2	2				2
PRIZREN	1	3	2	1		0.5	2.5
PEJË	5	16	10.5	15.5	9.5	12.5	23
GJILAN	3	3	3	0.5		0.25	3.25
MITROVICË	11	10	10.5	1.5	0.5	1	11.5
FERIZAJ	4	4	4				4
GJAKOVË	1	1	1	1	0.5	0.75	1.75
GJITHSEJ	30	42	36	19.5	10.5	15	51

Figura 16-c

(DROGAT) PERSONA (INFORMATA PPN)	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjdhura	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	4	4	4				4
PRISHTINË	2	2	2				2
PRIZREN	2	4	3	1		0.5	3.5
PEJË	7	21	14	18.5	10.5	14.5	28.5
GJILAN	5	5	5	1		0.5	5.5
MITROVICË	20	19	19.5	3.5	1	2.25	21.75
FERIZAJ	12	12	12				12
GJAKOVË	1	1	1	1	0.5	0.75	1.75
GJITHSEJ	53	68	60.5	25	12	18.5	79

Figura 16-ç

6. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE TABELAT PUNUESE PËR REALIZIMIN E PARASHIKIMIT
TË NGARKESËS ME LËNDË TË KORRUPSIONIT, NË FUND TË VITIT 2017 (Figura 17-a,b,c,ç)

(KORRUPSIONI) KALLËZIM PENALE	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjidhurave	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	43	39	41	13	19	-6	35
PRISHTINË	336	223	279.5	157	183.5	-26.5	253
PRIZREN	23	27	25	42	36.5	5.5	30.5
PEJË	22	21	21.5	53	55.5	-2.5	19
GJILAN	10	19	14.5	69	62	7	21.5
MITROVICË	71	82	76.5	38	25	13	89.5
FERIZAJ	19	17	18	25	31.5	-6.5	11.5
GJAKOVË	14	19	16.5	28	27	1	17.5
GJITHSEJ	538	447	492.5	425	440	-15	477.5

Figura 17-a

(KORRUPSIONI) PERSONA (KALLËZIME PENALE)	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015- 2016)	Mesatarja e të pazgjidhurave	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	263	162	212.5	28	86	-58	154.5
PRISHTINË	1018	655	836.5	217.5	356.5	-139	697.5
PRIZREN	64	69	66.5	62.5	55.5	7	73.5
PEJË	45	40	42.5	68.5	73.5	-5	37.5
GJILAN	17	48	32.5	122.5	105.5	17	49.5
MITROVICË	163	192	177.5	67	43.5	23.5	201
FERIZAJ	40	47	43.5	32	35.5	-3.5	40
GJAKOVË	30	35	32.5	32.5	32	0.5	33
GJITHSEJ	1640	1248	1444	630.5	788	-157.5	1286.5

Figura 17-b

(KORRUPSIONI) INFORMATA PPN	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjidhurave	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	53	55	54	30.5	17	13.5	67.5
PRISHTINË	168	404	286	152.5	88	64.5	350.5
PRIZREN	25	43	34	39.5	30	9.5	43.5
PEJË	39	68	53.5	49	22.5	26.5	80
GJILAN	11	4	7.5	13	13.5	-0.5	7
MITROVICË	45	55	50	18	4.5	13.5	63.5
FERIZAJ	43	50	46.5	33.5	29	4.5	51
GJAKOVË	15	21	18	13.5	8	5.5	23.5
GJITHSEJ	399	700	549.5	349.5	212.5	137	686.5

Figura 17-c

(KORRUPSIONI) PERSONA (INFORMATA PPN)	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjidhura	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	158	136	147	99.5	81.5	18	165
PRISHTINË	391	705	548	275	142	133	681
PRIZREN	49	64	56.5	55.5	49	6.5	63
PEJË	79	107	93	80.5	44.5	36	129
GJILAN	18	4	11	17.5	18.5	-1	10
MITROVICË	66	79	72.5	25.5	6	19.5	92
FERIZAJ	73	78	75.5	52.5	46	6.5	82
GJAKOVË	17	28	22.5	16.5	9	7.5	30
GJITHSEJ	851	1201	1026	622.5	396.5	226	1252

Figura 17-ç

7.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE TABELAT PUNUESE PËR REALIZIMIN E PARASHIKIMIT TË NGARKESËS ME LËNDË TË KRIMEVE EKONOMIKE, NË FUND TË VITIT 2017 (Figura 18-a,b,c,ç)

(KRIMET EKONOMIKE) KALLËZIM PENALE	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjdhurave	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	2	2	2	1	1	0	2
PRISHTINË	295	166	230.5	64.5	96.5	32	262.5
PRIZREN	56	51	53.5	83.5	92.5	9	62.5
PEJË	26	24	25	27	22.5	-4.5	20.5
GJILAN		4	2	37.5	37.5	0	2
MITROVICË	158	153	155.5	82	40	-42	113.5
FERIZAJ	44	50	47	45	37	-8	39
GJAKOVË	4	17	10.5	20.5	14.5	-6	4.5
GJITHSEJ	585	467	526	361	341.5	-19.5	506.5

Figura 18-a

(KRIMET EKONOMIKE) PERSONA (KALLËZIME PENALE)	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015- 2016)	Mesatarja e të pazgjdhurave	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	8	5	6.5	5.5	4	1.5	8
PRISHTINË	326	253	289.5	97	115.5	-18.5	271
PRIZREN	82	68	75	95	111.5	-16.5	58.5
PEJË	40	37	38.5	34.5	24.5	10	48.5
GJILAN		32	16	55.5	41.5	14	30
MITROVICË	253	229	241	115.5	58	57.5	298.5
FERIZAJ	84	91	87.5	69.5	50	19.5	107
GJAKOVË	7	35	21	33.5	20	13.5	34.5
GJITHSEJ	800	750	775	506	425	81	856

Figura 18-b

(KRIMET EKONOMIKE) INFORMATA PPN	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjdhurave	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	4	6	5	1	2	-1	4
PRISHTINË		100	50	26.5	6	20.5	70.5
PRIZREN	4	5	4.5	2.5	2.5	0	4.5
PEJË	36	34	35	40.5	45.5	-5	30
GJILAN	1		0.5	5.5	6.5	-1	-0.5
MITROVICË			0	0	0	0	0
FERIZAJ	20	27	23.5	56.5	58.5	-2	21.5
GJAKOVË			0	0	0	0	0
GJITHSEJ	65	172	118.5	132.5	121	11.5	130

Figura 18-c

(KRIMET EKONOMIKE) PERSONA (INFORMATA PPN)	Ngarkesa 2015	Ngarkesa 2016	Mesatarja ngarkesës (2015+2016:2)	Mesatarja pranimit (2015+2016:2)	Mesatarja zgjidhjes (2015+2016:2)	Mesatarja e të pazgjdhura	Parashikimi i ngarkesës në fund të 2017
	a	b	c (a+b:2)	ç	d	dh (ç-d)	e (c+dh)
PSRK	5	7	6	1	0	1	7
PRISHTINË		106	53	32	9.5	22.5	75.5
PRIZREN	4	5	4.5	2.5	0.5	2	6.5
PEJË	36	34	35	41	28	13	48
GJILAN	1		0.5	6	6.5	-0.5	0
MITROVICË			0	0	0	0	0
FERIZAJ	22	29	25.5	57.5	49	8.5	34
GJAKOVË			0	0	0	0	0
GJITHSEJ	68	181	124.5	140	93.5	46.5	171

Figura 18-ç

8. NGRITJA E PERFORMANCËS NË ZGJIDHJEN E KALLËZIMEVE PENALE

Në bazë të të dhënave, të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional, konstatohet se prokuroritë në vitin 2016 për gjashtë (6) grupe të veprave penale karakteristike kanë arritur apo tejkaluar kuotën prej 100% të kallëzimeve penale të zgjidhura në raport me kallëzimet penale të pranuar. Ndërsa, për tre (3) grupe të veprave penale karakteristike nuk është arritur kuota prej 100% të zgjidhjes së kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar.

8.1 PERFORMANCA E LARTË:

1. KONTRABANDIMI ME MIGRANTË: **123.52%**;
2. KRIMI ORGANIZUAR: **325%**;
3. KORRUPSIONI: **106.84%**
4. SHPËRLARJA E PARASË: **150%**;
5. KRIMET EKONOMIKE: **118.65%**.
6. NXITJA E URREJTJES: **100%**

8.2 PERFORMANCA E ULËT:

1. ARMËT: **57.14%**;
2. DROGAT: **62.62%**
3. TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE: **78.125%**.

9. ANALIZA E PERFORMANCËS SË LARTË

KONTRABANDIMI ME MIGRANT: Përqindja e zgjidhjes së kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar të Kontrabandimit me migrant është ngritur sipas viteve:

- Në vitin **2013** janë zgjidhur **61.70%**;
- Në vitin **2014** janë zgjidhur **62.50%**;
- Në vitin **2015** janë zgjidhur **84.62%**;
- Në vitin **2016** janë zgjidhur **123.52%**.

Konstatohet se në vitin 2016, për herë të parë është tejkaluar kouta e 100% të kallëzimeve penale zgjidhura në raport me kallëzimet penale të pranuar. Ky efikasitet i adresohet kryesisht Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e cili ka zgjidhur **33.33%** të kallëzimeve penale të zgjidhura nga të gjitha prokuroritë (Figura 19).




Figura 19

Gjithashtu, konstatohet se në fund të vitin 2016 ngarkesa me lëndë (kallëzime penale për veprën penale të kontrabandimit me migrant) në nivel vendi, është zvogëluar për **11.11%** në raport me ngarkesën me lëndë në fund të vitin 2015.

KRIMI I ORGANIZUAR: Trajtimi i lëndëve për veprën penale të krimit të organizuar është në kompetencë ekskluzive e Prokurorisë Speciale, andaj në bazë të të dhënave lidhur me zgjidhjen e kallëzimeve penale të krimeve ekonomike në raport me kallëzimet penale të pranuar, konstatohet se:

- Në vitin **2013** janë zgjidhur **18.18%**;
- Në vitin **2014** janë zgjidhur **36.36%**;
- Në vitin **2015** janë zgjidhur **57.14%**;
- Në vitin **2016** janë zgjidhur **325%**.

Konstatohet se në vitin 2016, për herë të parë është tejkaluar kouta e 100% të kallëzimeve penale zgjidhura në raport me kallëzimet penale të pranuar. Ky efikasitet i adresohet Prokurorisë Speciale, e cili ka zgjidhur **325%** të kallëzimeve penale të zgjidhura në raport me kallëzimet penale të pranuar. Gjithashtu, konstatohet se në fund të vitin 2016 **ngarkesa me lëndë** (kallëzime penale për veprën penale të krimit të organizuar) në nivel vendi, është zvogëluar për **18.36%** në raport me ngarkesën me lëndë në fund të vitin 2015.

KORRUPSIONI: Përqindja e zgjidhjes së kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar të korrupsionit është ngritur sipas viteve:

- Në vitin **2013** janë zgjidhur **72.02%**;
- Në vitin **2014** janë zgjidhur **88.27%**;
- Në vitin **2015** janë zgjidhur **100%**;
- Në vitin **2016** janë zgjidhur **106.84%**.

Konstatohet se në vitin 2016, për herë të parë është tejkaluar kouta e 100% të kallëzimeve penale zgjidhura në raport me kallëzimet penale të pranuar. Ky efikasitet i adresohet politikave të Këshillit Prokurorial të Kosovës në krijimin dhe zbatimin e planit strategjik (2016-2018), si dhe efikasitetit të Njësitit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, i cili ka zgjidhur **44.23%** të kallëzimeve penale të zgjidhura nga të gjitha prokuroritë, ndërsa **174.76%** të kallëzimeve penale të pranuar në PTh.Prishtinë në vitin 2016 (Figura 20).




Figura 20

Gjithashtu, konstatohet se në fund të vitin 2016 **ngarkesa me lëndë** (kallëzime penale për veprën penale të korrupsionit) në nivel vendi, është zvogëluar për **6.28%** në raport me ngarkesën me lëndë në fund të vitin 2015.

SHPËRLARJA E PARASË: Trajtimi i lëndëve për veprën penale të shpërlarjes së parasë është në kompetencë ekskluzive e Prokurorisë Speciale, andaj në bazë të të dhënave lidhur me zgjidhjen e kallëzimeve penale të krimeve ekonomike në raport me kallëzimet penale të pranuar, konstatohet se:

- Në vitin **2013** janë zgjidhur **138.89%**;
- Në vitin **2014** janë zgjidhur **127.27%**;
- Në vitin **2015** janë zgjidhur **77.78%**;
- Në vitin **2016** janë zgjidhur **150%**.

Konstatohet se në vitin 2016, prokuroria speciale ka arritur të zgjidhur 150% të kallëzimeve penale në raport me numrin e kallëzimeve penale të pranuar, andaj efikasitet i vazhdueshëm në zgjidhjen e lëndëve të kësaj natyre i adresohet Prokurorisë Speciale. Sipas të dhënave të mekanizmit përcjellës në Prokurorinë Themelore në Prizren janë regjistruar (si lëndë të bartuara) 2 kallëzime penale që i përkasin veprës penale të shpërlarjes së parasë, e që në fakt trajtimi i lëndëve të kësaj natyre i takon vetëm prokurorisë speciale.

Gjithashtu, konstatohet se në fund të vitin 2016 **ngarkesa me lëndë** (kallëzime penale për veprën penale të shpërlarjes së parasë) në nivel vendi (respekvisht në PSRK), është zvogëluar për **6.45%** në raport me ngarkesën me lëndë në fund të vitin 2015.

KRIMET EKONOMIKE: Përqindja e zgjidhjes së kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar të krimeve ekonomike është ngritur sipas viteve:

- Në vitin **2013** krimet ekonomike nuk kanë qenë të përhira në Mekanizmin Përcjellës;
- Në vitin **2014** janë zgjidhur **73.09%**;
- Në vitin **2015** janë zgjidhur **72.82%**;
- Në vitin **2016** janë zgjidhur **118.65%**.

Konstatohet se në vitin 2016, për herë të parë është tejkaluar kouta e 100% të kallëzimeve penale zgjidhura në raport me kallëzimet penale të pranuar. Ky efikasitet i adresohet politikave të Këshillit Prokurorial të Kosovës në krijimin dhe zbatimin e planit strategjik (2016-2018), si dhe efikasitetit të Njësitit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, i cili ka zgjidhur **45.94%** të kallëzimeve penale të zgjidhura nga të gjitha prokuroritë, ndërsa **174.76%** të kallëzimeve penale të pranuar në PTh.Prishtinë në vitin 2016 (*Figura 21*).




Figura 21

Gjithashtu, konstatohet se në fund të vitin 2016 **ngarkesa me lëndë** (kallëzime penale për veprën penale të krimeve ekonomike) në nivel vendi, është zvogëluar për **12.05%** në raport me ngarkesën me lëndë në fund të vitin 2015.

NXITJA E URREJTJES: Përqindja e zgjidhjes së kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar për veprën penale të nxitjes së urrejtjes është ngritur:

- Në vitin **2013** nuk ka qenë e përhirë në Mekanizmin Përcjellës;
- Në vitin **2014** nuk ka qenë e përhirë në Mekanizmin Përcjellës;
- Në vitin **2015** janë zgjidhur **50%**;
- Në vitin **2016** janë zgjidhur **100%**.

Konstatohet se në vitin 2016, për herë të parë është arritur kouta prej 100% të kallëzimeve penale zgjidhura në raport me kallëzimet penale të pranuar për veprën penale të nxitjes së urrejtjes. Krijimi i efikasitetit në zgjidhjen e kallëzimeve penale për veprën penale të shpërlarjes së parasë i adresohet kryesisht Prokurorisë Themelore në Ferizaj e cila ka zgjidhur **40%** të kallëzimeve penale nga tërësia e kallëzimeve penale të zgjidhura nga të gjitha prokuroritë (*Figura 22*).




Figura 22

Konstatohet se në fund të vitin 2016 **ngarkesa me lëndë** (kallëzime penale për veprën penale të shpërlarjes së parasë, në nivel vendi, ka mbetur e njëjtë në raport me ngarkesën me lëndë në fund të vitin 2015.

10. ANALIZA E PERFORMANCËS SË ULËT

ARMËT: Përqindja e zgjidhjes së kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar për veprën penale të Armëve, në vitin 2016 rezulton negativisht në krahasim me vitet tjera:

- Në vitin 2013 janë zgjidhur **50%**;
- Në vitin 2014 janë zgjidhur **117.39%**;
- Në vitin 2015 janë zgjidhur **92.31%**;
- Në vitin 2016 janë zgjidhur **57.14%**.

Konstatohet se në vitin 2016, prokuroritë kanë pranuar në punë 14 ndërsa kanë zgjidhur 8 kallëzime penale për veprën penale të Armëve apo **57.14%**. Efikasiteti i ulët në zgjidhjen e lëndëve të kësaj natyre i adresohet, në përgjithësi, të gjitha prokurorive. Konstatohet se në fund të vitin 2016 **ngarkesa me lëndë** (kallëzime penale për veprën penale të Armëve) në nivel vendi, ka rezultuar me ngritje prej **20%** në raport me ngarkesën me lëndë në fund të vitin 2015.

DROGAT: Përqindja e zgjidhjes së kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar për veprën penale të Drogave, në vitin 2016 rezulton negativisht në krahasim me vitet tjera:

- Në vitin 2013 janë zgjidhur **68.72%**;
- Në vitin 2014 janë zgjidhur **68.49%**;
- Në vitin 2015 janë zgjidhur **77.40%**;
- Në vitin 2016 janë zgjidhur **62.62%**.

Konstatohet se niveli i ulët i zgjidhjes së kallëzimeve penale për veprën penale të Drogave, në kuotën prej **62.62%** në raport me kallëzimet penale të pranuar në vitin 2016, i adresohet kryesisht mungesës së efikasitetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për faktin se në vitin 2016 kjo prokurori ka zgjidhur vetëm **30.04%** të kallëzimeve penale të pranuar në vitin 2016. Mosefikasiteti në zgjidhjen e kallëzimeve penale në Prokurorinë Themelore në Prishtinë ka ndikuar edhe në ngritjen e ngarkesës me lëndë në nivel vendi, për faktin se në vitin 2016 ngarkesa me lëndë të rritur për **49.18%** në raport me ngarkesën e vitit 2015 (ishte 555 në vitin 2015 ndërsa ka arritur në 828 kallëzime penale në vitin 2016). Prokuroria Themelore në Prishtinë mban **58% të** ngarkesës së tërësishtme të lëndëve në nivel vendi (Figura 23).




Figura 23

TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE: Përqindja mesatare, për katër (4) vite, e zgjidhjes së kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar për veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore, në vitin 2016 rezulton të jetë rreth 72%, dhe në asnjërin prej vetive respektive nuk është arritur të zgjidhen 100% të kallëzimeve penale të pranuar:

- Në vitin 2013 janë zgjidhur **73.33%**;
- Në vitin 2014 janë zgjidhur **66.67%**;
- Në vitin 2015 janë zgjidhur **68%**;
- Në vitin 2016 janë zgjidhur **78.12%**.

Konstatohet se niveli i ulët i zgjidhjes së kallëzimeve penale për veprën penale të Trafikimit me qenie njerëzore, në kuotën mesatare, për katër vite, prej **72%** në raport me kallëzimet penale të pranuar, i adresohet kryesisht mungesës së efikasitetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për faktin se në vitin 2016 kjo prokurori ka zgjidhur vetëm **40%** të kallëzimeve penale të pranuar në vitin 2016. Mosefikasiteti në zgjidhjen e kallëzimeve penale në Prokurorinë Themelore në Prishtinë për faktin se:

- Në vitin 2013 ka zgjidhur **100%** të kallëzimeve penale të pranuar;
- Në vitin 2014 ka zgjidhur **44.44%** të kallëzimeve penale të pranuar;
- Në vitin 2015 ka zgjidhur **57.14%** të kallëzimeve penale të pranuar;
- Në vitin 2016 ka zgjidhur **40%** të kallëzimeve penale të pranuar;

Konstatohet se në vitin 2016 ngarkesa me lëndë (kallëzime penale) në nivel vendi është rritur për **14%** në raport me ngarkesën e vitit 2015 (ishte 50 në vitin 2015 ndërsa ka arritur në 57 kallëzime penale në vitin 2016). Prokuroria Themelore në Prishtinë mban **58%** të ngarkesës së tërësishtme të kallëzimeve penale në nivel vendi (Figura 24).




Figura 24

11. PERFORMANCA NË ZGJIDHJEN E RASTEVE PËR PERSONA

Në bazë të të dhënave, të pasqyruara në tabelën si më lartë (shih figurën 8) të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional, konstatohet se prokuroritë në vitin 2016 për pesë grupe të veprave penale karakteristike kanë arritur apo tejkaluar kuotën prej 100% rasteve të zgjidhura për PERSONA në raport me rastet e pranuar për PERSONA. Ndërsa, për tre (3) grupe të veprave penale karakteristike nuk është arritur kuota prej 100% të zgjidhjes së rasteve për PERSONA në raport me rastet e pranuar për PERSONA.

11.1 PERFORMANCA E LARTË NË ZGJIDHJEN E RASTEVE PËR PERSONA NË VITIN 2016:

1. KONTRABANDIMI ME MIGRANTË: **137.5%**;
2. KRIMI ORGANIZUAR: **222.89%**;
3. KORRUPSIONI: **137.10%**;
4. SHPËRLARJA E PARASË: **150%**;
5. KRIMET EKONOMIKE: **118.65%**;
6. NXITJA E URREJTJES: **100%**

11.2 PERFORMANCA E ULËT NË ZGJIDHJEN E RASTEVE PËR PERSONA NË VITIN 2016:

1. ARMËT: **84%**;
2. DROGAT: **64.17%**
3. TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE: **94.73%**.

12. ANALIZA MBI NGRITJEN E EFIKASITETIT NË ZGJIDHJEN E RASTEVE PËR PERSONA KONTRABANDIMI ME MIGRANT – PERSONAT:

Përqindja e zgjidhjes së rasteve për PERSONA në raport me rastet e pranuar për PERSONA, për veprën penale të Kontrabandimit me migrant është ngritur sipas viteve:

- Në vitin **2013** janë zgjidhur **86.82%**;
- Në vitin **2014** janë zgjidhur **82.20%**;
- Në vitin **2015** janë zgjidhur **105.81%**;
- Në vitin **2016** janë zgjidhur **137.5%**.

Konstatohet se në vitin 2016, zgjidhja e rasteve për Persona në raport me rastet e pranuar për persona ka arritur përqindjen më të lartë, prej **137.5%** që nga themelimi i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional. Ky efikasitet i adresohet Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e cila ka zgjidhur **46.42%** të rasteve të PERSONA nga numri i përgjithshëm i rasteve të zgjidhura për persona në nivel vendi (Figura 25).




Figura 25

Gjithashtu, konstatohet se në fund të vitin 2016 ngarkesa me persona të përfshirë në veprën penale të kontrabandimit me migrant në nivel vendi, është zvogëluar për **11.11%** në raport me ngarkesën me persona në vitin paraprak (2015).

KRIMI ORGANIZUAR – PERSONAT: Përqindja e zgjidhjes së rasteve për PERSONA në raport me rastet e pranuar për PERSONA, për veprën penale të Krimit të organizuar është ngritur sipas viteve:

- Në vitin **2013** janë zgjidhur **9.78%**;
- Në vitin **2014** janë zgjidhur **75.76%**;
- Në vitin **2015** janë zgjidhur **72.44%**;
- Në vitin **2016** janë zgjidhur **222.89%**.

Konstatohet se në vitin 2016, zgjidhja e rasteve për Persona në raport me rastet e pranuar për persona ka arritur përqindjen më të lartë, prej **222.89%** që nga themelimi i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional. Ky efikasitet i adresohet Prokurorisë Speciale, e cila ka zgjidhur **222.89%** të rasteve të PERSONA në raport me numrin e personave të pranuar. **Vërejtje:** Potencojmë se Prokuroria Themelore në Prishtinë ka të regjistruar në mekanizmin përcjellës 2 kallëzime penale me 2 persona për veprën penale të krimit të organizuar si dhe Prokuroria Themelore në Ferizaj ka regjistruar 1 kallëzim penal me 2 persona, për këtë vepër penale e cila është kompetencë ekskluzive e Prokurorisë Speciale. Gjithashtu, konstatohet se në fund të vitin 2016 ngarkesa me persona të përfshirë në veprën penale të kontrabandimit me migrant në nivel vendi, është zvogëluar për **11.11%** në raport me ngarkesën me persona në vitin paraprak (2015).

KORRUPSIONI – PERSONAT: Përqindja e zgjidhjes së rasteve për PERSONA në raport me rastet e pranuar për PERSONA, për veprën penale të Kontrabandimit me migrant është ngritur sipas viteve:

- Në vitin **2013** janë zgjidhur **63.58%**;
- Në vitin **2014** janë zgjidhur **100%**;
- Në vitin **2015** janë zgjidhur **106.86%**;
- Në vitin **2016** janë zgjidhur **137.10%**.

Konstatohet se në vitin 2016, zgjidhja e rasteve për Persona në raport me rastet e pranuar për persona ka arritur përqindjen më të lartë, prej **137.10%** që nga themelimi i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional. Ky efikasitet i adresohet Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e cila ka zgjidhur **47.50%** të rasteve të PERSONA nga numri i përgjithshëm i rasteve të zgjidhura për persona në nivel vendi (Figura 26) apo edhe **197.50%** të rasteve të pranuar për persona në PTh. Prishtinë në vitin 2016.




Figura 26

13. IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT DHE PROPOZIMI PËR ZGJIDHJE: PTH PRISHTINË

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngarkesën më të madhe me lëndë që i takojnë grupit të veprave penale të Drogave, Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike. Në zbatim të planit strategjik 2016-2018 për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka krijuar Njësitin e veçantë në PTh. Prishtinë përmes së cilit ka pretenduar zvogëlimin e ngarkesës me lëndë si dhe ngritjen e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të pranuar për veprat penale të Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike. Të gjeturat e këtij raporti rezultojnë se veprat penale të Drogave kanë ngarkesën më të madhe me lëndë në këtë prokurori, mirëpo të njëjtat nuk janë objekt i trajtimit nga prokurorët e Njësitit.

Në Njësitin në PTh. Prishtinë aktualisht janë nëntë (9) prokurorë, prej të cilëve gjashtë (6) prokurorë i trajtojnë lëndët e Korrupsionit ndërsa, tre (3) prokurorë i trajtojnë lëndët e krimeve ekonomik duke përfshirë edhe një vepër penale të korrupsionit nga neni 437 i Kodit Penal të Kosovës. Norma orientuese vjetore e prokurorëve të krimeve të rënda është zgjidhja e 6 lëndëve në muaj apo 66 lëndëve në vit (11 muaj), ndërsa për prokurorët e departamentit të përgjithshëm norma mujore është 23 lëndë ndërsa vjetore 253 lëndë (11 muaj). Në bazë të këtyre parametrave të përcaktuar për zgjidhjen sasiore të lëndëve duke përfshirë edhe normën lidhur me kompleksitetin e lëndëve të korrupsionit rezulton se Njësi i në Prokurorinë Themelore në Prishtinë i ka kapacitetet që gjatë një viti të zgjidhë 297 Kallëzime penale të Korrupsionit dhe 660 kallëzime penale të krimeve ekonomike (Figura 27):

KORR dhe E	Nr. Prokurorëve	Lëndë të zgjidhura të Korrupsionit për 1 muaj	Lëndë të zgjidhura të Krimeve Ekonomike për një muaj	Lëndë të zgjidhura të Korrupsionit për 1 vit (11 muaj) nga Njësi i	Lëndë të zgjidhura të Krimeve Ekonomike për 1 vit (11 muaj)
	a	b	c		
DKR	6	18		198	
DP	3	9	60	99	660
Gjithsej:				297	660

Figura 27

Nëse nga numri prej 198 kallëzimeve penale të zgjidhura të korrupsionit tërheqim 18 kallëzime penale të cilat i konvertojmë në Informata PPN të zgjidhura, e të cilat përlllogariten në koeficientin: 1 kallëzim penale për 8 Informata PPN, atëherë rezulton se Njësi i në PTh. Prishtinë gjatë një viti, sipas normës orientuese (Figura 28), mund të zgjidhë:

- 279 Kallëzime penale të korrupsionit ($297-18=279$);
- 144 Informata PPN të korrupsionit ($18 \times 8=144$).

Nëse nga numri prej 660 kallëzimeve penale të zgjidhura të krimeve ekonomike tërheqim 60 kallëzime penale të cilat i konvertojmë në Informata PPN të zgjidhura, e të cilat përlllogariten në koeficientin: 1 kallëzim penle për 8 Informata PPN, atëherë rezulton se Njësi i në PTh. Prishtinë gjatë një viti, sipas normës orientuese (Figura 29), duhet të zgjidhë:

- 600 kallëzime penale të krimeve ekonomike ($660-60=600$);
- 480 Informata PPN të krimeve ekonomike ($60 \times 8=480$).

KORRUPSIONI	Ngarkesa në vitin 2016	Mesatarja vjetore e lëndëve të pranuar (2015=2016:2)	Të zgjidhura gjatë vitit 2017, sipas normës orientuese, nga 6 prokurorë të Njësitit	Ngarkesa me lëndë në fund të vitit 2017
	a	b	c	ç (a+b-c)
Kallëzime penale	223	157	279	101
Informata PPN	404	151	144	411

Figura 28

KRIMET EKONOMIKE	Ngarkesa në vitin 2016	Mesatarja vjetore e lëndëve të pranuar (2015=2016:2)	Të zgjidhura 3 prokurorë të Njësitit, gjatë vitit 2017, sipas normës orientuese	Ngarkesa me lëndë në fund të vitit 2017
	a	b	c	ç (a+b-c)
Kallëzime penale	166	64	600	-370
Informata PPN	253	27	480	-200

Figura 29

Meqenëse ngarkesa me lëndë të Drogave përbën numrin më të madh të lëndëve në PTh. Prishtinë të veprave penale karakteristike, shtrohet nevoja e krijimit të politikave efektive për trajtimin, zgjidhjen dhe zvogëlimin e ngarkesës me lëndë të kësaj natyre. **Analizë:** Ngarkesa me lëndë të Drogave në fillim të vitit 2016 ishte 306 kallëzime penale ndërsa gjatë vitit 2016 janë pranuar edhe 243 kallëzime penale, që rezulton se në vitin 2016 Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte në punë gjithsej 549 kallëzime penale të Drogave (Figura 30). Grupi i veprave penale të Drogave në Mekanizmin përcjellës përfshinë tetë (8) nene të Kodit penal të Kosovës (nenet: 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279 dhe 280), mirëpo lëndët nga neni 275 trajtohen nga prokurorët e Departamentit të përgjithshëm, e të cilat përbëjnë 70% të lëndëve të grupit të Drogave në Mekanizmin përcjellës. Nga të dhënat e gjeneruara nga baza e të dhënave të Mekanizmit përcjellës rezulton se nga 478 kallëzimet penale të Drogave 372 prej tyre i takojnë neni 275 ndërsa 106 kallëzime penale i takojnë neneve tjera të Drogave.

DROGAT	Ngarkesa në vitin 2016	Mesatarja vjetore e lëndëve të pranuar (2015=2016:2)	Të zgjidhura gjatë vitit 2017, sipas normës orientuese, nga prokurorët e Njësitit	Ngarkesa me lëndë në fund të vitit 2017
	a	b	c	ç (a+b-c)
Kallëzime penale nga neni 275	372	176	759	-196
Kallëzime penale nga nenet tjera:	106	82	132	56
Gjithsej:	478	258		

Figura 30

Këshilli Prokurorial i Kosovës në kontekstin e krijimit të politikave strategjike, e në këtë rast për trajtimin efikas të lëndëve të Drogave, të bëjë plotësim ndryshimin e Planit strategjik 2016-2018 për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike duke përfshirë edhe trajtimin e lëndëve të Drogave në Njësitin e PTh. Prishtinës. Për më tej, dy (2) prokurorë të krimeve të përgjithshme të caktohen në Njësit , për trajtimin e lëndëve të Drogave për veprat penale nga nenet 273, 274, 276, 277, 278, 279 dhe 280. Ndërsa, lëndët nga neni 275 për vepën penale të Drogave të trajtohen nga tre (3) prokurorët e Departamentit të përgjithshëm që aktualisht janë në Njësitin e PTh. Prishtinës.

Me plotësim ndryshimin e planit strategjik 2016-2018, në pajtim me propozimin si më lartë, pretendohet të deri në fund të vitit 2018 problematika e ngarkesës me lëndë për veprat penale të Drogave,

Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike, do të jetë kapitull i mbyllur (Figura 31):

- Shtatë (7) prokurorët e krimeve të rënda të Njësitit, do të trajtojnë veprat penale të korrupsionit. Në zbatim të normës orientuese për zgjidhjen e lëndëve të ndërlikuar, në fund të vitit 2018 problemi i ngarkesës me lëndë të korrupsionit do të ishte kapitull i mbyllur.
- Tre (3) prokurorë të krimeve të përgjithshme të Njësitit, do të trajtonin veprat penale të krimeve ekonomike, veprën penale të korrupsionit nga neni 437 dhe veprën penale të Drogave nga neni 275. Në zbatim të normës orientuese për zgjidhjen e lëndëve të departamentin e përgjithshëm, në fund të vitit 2018 problemi i ngarkesës me lëndët, objekt i trajtimit të këtij departamenti, do të ishte kapitull i mbyllur.
- Dy (2) prokurorë të krimeve të rënda, të cilët do t'i bashkoheshin Njësitit në PTh. Prishtinë, sipas propozimit për plotësim ndryshimin e planit strategjik 2016-2018, do të trajtonin, të gjitha veprat penale të grupit të Drogave në mekanizmin përcjellës (përveç veprave penale nga neni 275). Në zbatim të normës orientuese për zgjidhjen e lëndëve të krimeve të rënda, në fund të vitit 2018, problemi i ngarkesës me lëndët e drogave, do të ishte kapitull i mbyllur.

NJËSI TI	LËNDËT	Numri prokuror	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
KORR	K.P (PP)	7	DKR	190	133	323	231-31=200	123	133	256	231-31=200	56	
		3	DP	33	24	57	99-9=90	-33					
	INFO (PPN)	6	DKR	343	128	471	31X8=248	223	128	351	31X8=248	103	
		3	DP	61	23	84	9X8=72	12	23	35	9X8=72	-37	
E	K.P (PP)			166	64	230	759-39=720	-490					
	INFO(PPN)	3	DP	253	27	280	39X8=312	-32					
DR	K.P (PP)	2	DKR	106	82	188	132	56	82	138	132	6	
		3	DP	372	176	548	759	-211					

Figura 31

14. IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT DHE PROPOZIMI PËR ZGJIDHJE: PTH MITROVICË

DROGAT: Prokuroria Themelore në Mitrovicë në vitin 2016 ka pranuar 91 kallëzime penale (të Drogave) prej të cilave ka zgjidhur 69 apo 75.82 të kallëzimeve penale. Ndërsa, nga 124 persona të pranuar ka zgjidhur 97 apo 78.22%. Prokuroria Themelore në Mitrovicë në vitin 2016: nga 200 kallëzime penale në punë (*ngarkesa me lëndë dhe lëndë të reja*) ka zgjidhur 91 apo 45.50% të kallëzimeve penale, ndërsa nga 291 persona në punë (*ngarkesa me persona dhe raste të reja për persona*) ka zgjidhur 97 apo 33.33%. Nga analiza e realizuar, objekt i këtij raporti, në bazë të matjes së mesatares së ngarkesë, pranimi dhe zgjidhjes së lëndëve në vitet 2015 dhe 2016, pretendohet se PTh. në Mitrovicë në fund të vitit 2017 do të ketë rritje të ngarkesës me lëndë në raport me ngarkesën me lëndë në fund të vitit 2016, respektivisht:

- Nga 131 kallëzime penale (2016) pretendohet të ngritet në 153 kallëzime penale (2017);
- Nga 195 persona (2016) pretendohet të ngritet në 226 persona (2017);

Rezultatet e kësaj analize, që i referohet trendit të zvogëlimit të ngarkesës me lëndë dhe rritjes së efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja pasqyrojnë nevojën e adresimit të kësaj problematike në një dimension tjetër në kuadër të politikave të KPK-së, për shkak të rrezikimit të realizimit të objektivave të planit dhe veprimit strategjik 2016-2018.

KORRUPSIONI: Prokuroria Themelore në Mitrovicë në vitin 2016 ka pranuar 33 kallëzime penale (të Drogave) prej të cilave ka zgjidhur 23 apo 69.69%, ndërsa, nga 91 persona të pranuar ka zgjidhur 60 apo 65.93%. Prokuroria Themelore në Mitrovicë në vitin 2016: nga 105 kallëzime penale në punë (*ngarkesa me lëndë dhe lëndë të reja*) ka zgjidhur 23 apo 21.90%, ndërsa nga 252 persona në punë (*ngarkesa me persona dhe raste të reja për persona*) ka zgjidhur 60 apo 23.80%. Nga analiza e realizuar, objekt i këtij raporti, në bazë të matjes së mesatares së ngarkesë, pranimi dhe zgjidhjes së lëndëve në vitet 2015 dhe 2016, pretendohet se PTh. në Mitrovicë në fund të vitit 2017 do të ketë rritje të ngarkesës me lëndë në raport me ngarkesën me lëndë në fund të vitit 2016, respektivisht:

- Nga 82 kallëzime penale (2016) pretendohet të ngritet në 89 kallëzime penale (2017);
- Nga 192 persona (2016) pretendohet të ngritet në 201 persona (2017);

Rezultatet e kësaj analize, që i referohet trendit të zvogëlimit të ngarkesës me lëndë dhe rritjes së efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja pasqyrojnë nevojën e adresimit të kësaj problematike në një dimension tjetër në kuadër të politikave të KPK-së, për shkak të rrezikimit të realizimit të objektivave të planit dhe veprimit strategjik 2016-2018.

KRIMET EKONOMIKE: Prokuroria Themelore në Mitrovicë në vitin 2016 ka pranuar 24 kallëzime penale (të Drogave) prej të cilave ka zgjidhur 29 apo 120%, ndërsa, ka pranuar 29 persona dhe ka zgjidhur 50 apo 172.41%. Prokuroria Themelore në Mitrovicë në vitin 2016: nga 182 kallëzime penale në punë (*ngarkesa me lëndë dhe lëndë të reja*) ka zgjidhur 29 apo 15.93%, ndërsa nga 279 persona në punë (*ngarkesa me persona dhe raste të reja për persona*) ka zgjidhur 50 apo 17.92%. Nga analiza e realizuar, objekt i këtij raporti, në bazë të matjes së mesatares të indikatorëve të ngarkesës, pranimi dhe zgjidhjes së lëndëve në vitet 2015 dhe 2016, pretendohet se PTh. në Mitrovicë në fund të vitit 2017 do të ketë zvogëlim të ngarkesës me kallëzime penale ndërsa rritje të ngarkesës me persona, në raport me lëndë në fund të vitit 2016, respektivisht:

- Nga 153 kallëzime penale (2016) pretendohet të zvogëlohet në 113 kallëzime penale (2017);
- Nga 229 persona (2016) pretendohet të ngritet në 298 persona (2017);

Rezultatet e kësaj analize, që i referohet trendit të zvogëlimit të ngarkesës me lëndë dhe rritjes së efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja pasqyrojnë nevojën e adresimit të kësaj problematike në një dimension tjetër në kuadër të politikave të KPK-së, për shkak të rrezikimit të realizimit të objektivave të planit dhe veprimit strategjik 2016-2018.

15. PLANIFIKIMI PËR NGRITJEN E EFIKASITETIT NË PTH. MITROVICË

Prokuroria Themelore në Mitrovicë rezulton të ketë ngarkesë të madhe me lëndët e Drogave, Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike dhe për zbatimin e planit dhe veprimit strategjik 2016-2018 lidhur me zvogëlimin e ngarkesë me lëndë dhe rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja, konstatohet se për arritjen e këtyre dy objektivave në kuadër të politikave të KPK-së, kërkohet ndryshimi i çasjes në zgjidhjen e lëndëve të këtyre natyrave.

15.1 KORRUPSIONI:

Meqenëse ngarkesa me lëndët e Korrupsionit përfshinë 82 kallëzime penale me 192 persona dhe 55 Informata me 79 persona, propozojmë që në PTh. Mitrovicë të caktohen dy (2) prokurorë i cili do të trajtonte të gjitha lëndët e Korrupsionit, e me këtë rast do të zbatohet edhe qëllimi i profilizimit të prokurorit për trajtimin e lëndëve të kësaj natyre (Figura 32).

	KORRUPSIONI	Numri prokurorëve	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
1	Kallëzime penale	2	DKR	82	38	120	66	54	38	92	66	26	
2	Informata PPN			55	18	73	48	25	18	43	48	-5	

Figura 32

Konstatohet se me caktimin e dy prokurorëve të cilët ekskluzivisht do të trajtojnë lëndët e korrupsionit, në bazë të normës orientuese për lëndët e ndërlikuara, në fund të vitit 2018, në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë ngarkesa me lëndë do të ketë 26 kallëzime penale, ndërsa problematika e ngarkesës me Informata PPN do të jetë kapitull i mbyllur. Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes realizimit të kësaj politike strategjike përveç zbatimit të qëllimit për profilizimin e prokurorëve, do të zvogëlon ngarkesën me lëndë si dhe do të rritë efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve të reja.

15.2 KRIMET EKONOMIKE:

Meqenëse ngarkesa me lëndët e krimeve ekonomike në fund të vitit 2016 rezulton me 153 kallëzime penale dhe 229 persona, propozojmë që në PTh. Mitrovicë të caktohen një (1) prokurorë i cili do të trajtonte të gjitha lëndët e krimeve ekonomike. Në bazë të normës orientuese prokurorët e Departamentit të përgjithshëm obligohet të kryejnë 23 kallëzime penale në muaj apo 253 kallëzime penale gjatë vitit. Prokurori i caktuar për trajtimin e lëndëve të veprave penale të krimeve ekonomike do të trajton edhe lëndët nga neni 275 për veprën penale të Drogave të cilat sipas kompetencës lëndore i takojnë departamentit të përgjithshëm (Figura 33):

	KRIMET EKONOMIKE DHE DROGAT NË DEPARTAMENTIN E PËRGJITHSHËM	Numri prokurorëve	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
1	Krimet ekonomike	1	DP	153	82	235	150	85	82	167	150	17	
2	Drogat-neni 275			93	63	156	103	53	63	116	103	13	
	Gjithsej:			246	145	391	253	138	145	273	253	30	

Figura 33

Konstatohet se me caktimin e një (1) prokurori nga Departamenti i përgjithshëm për trajtimin, ekskluzivisht, të lëndëve të krimeve ekonomike dhe lëndëve të Drogave nga neni 275, në bazë të normës orientuese, në fund të vitit 2018, në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë ngarkesa me lëndët e krimeve ekonomike dhe të Drogave nga neni 275 do të zvogëlohet dukshëm. Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes realizimit të kësaj politike strategjike përveç zbatimit të qëllimit për profilizimin e prokurorëve, do të zvogëlon ngarkesën me lëndë si dhe do të rritë efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve të reja.

15.3 DROGAT:

Meqenëse ngarkesa me lëndët e Drogave në fund të vitit 2016 në PTh. Mitrovicë rezulton me 131 kallëzime penale dhe 195 persona, prej të cilave (në bazë të mesatares 1.4 lëndë i takojnë nenin 275) 38 kallëzime penale i përkasin neneve tjera ndërsa 93 kallëzime penale i përkasin nenit 275 të veprave penale të Drogave. Me qëllim të zbatimit të politikave strategjike të KPK-së (propozimi për plotësimin dhe ndryshimi e planit strategjik 2016-2018) në zvogëlimin e ngarkesës me lëndë dhe rritjes së efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja, **propozojmë:**

PROPOZIMET:

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bashkëpunim me Kryeprokurorin e PTh. Mitrovicës të caktojnë dy (2) prokuror nga Departamenti për krime të rënda të cilët deri në fund të vitit 2017, ekskluzivisht do të trajtojnë lëndët e veprave penale të Drogave (përveç nga neni 275) (Figura 34):

Konstatohet se me caktimin e dy (2) prokurorëve nga Departamenti i përgjithshëm për trajtimin, ekskluzivisht, të lëndëve të Drogave (përveç nga neni 275), në bazë të normës orientuese, në fund të vitit 2018, në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë ngarkesa me lëndët e Drogave do të zvogëlohet ndjeshëm.

Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes realizimit të kësaj politike strategjike përveç zbatimit të qëllimit për profilizimin e prokurorëve, do të zvogëlon ngarkesën me lëndë si dhe do të rritë efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve të reja.

	DROGAT	Numri prokurorëve	Departamenti	2017					2018				
				Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja	Ngarkesa	Pranimi	Totali	Zgjidhja	Mbetja
1	Kallëzime penale	2	DKR	38	26	64	66	-2					
	KPenale nga neni 275	1	DP	93	63	156	253						
	Gjithsej:			131	89	220	319						

Figura 34